**REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - SHTATOR 2024**

| NR. RENDOR | DATA E KËRKESËS | OBJEKTI I KËRKESËS | DATA E PËRGJIGJES | PËRGJIGJE | MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË | TARIFA |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 16.09.2024 | Kërkesë për informacion | 01.10.2024 | Pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit është protokolluar shkresa ..., me anë të së cilës kërkohet informacion nëse gjurma e projekt propozimit prek ....<br>Në vijim, sikurse jeni në dijeni Këshilli Kombëtar i Territorit në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ka miratuar me kusht Vendimin....<br>Për sa më sipër.. po ju dërgojmë për shqyrtim dhe kompetencë shkresën .., referuar dhe në zbatim të Nenit 24, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se "Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet, ia përcjell kërkesën mënjëherë, organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë". | E plotë | nuk ka |
| 3 | 18.09.2025 | Kërkesë për informacion | 24.09.2024 | Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se: Nga verifikimi i kryer rezultoi se pasuria juaj ndodhet brenda zonës...<br>Në vijim sqarojmë se Këshilli Kombëtar i Territorit në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar si dhe VKM-së 408,datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e ndryshuar, ka miratuar Vendim Nr.23 datë 28.02.2020 "*Për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e aplikimeve,brenda zonës së brezit bregdetar* ", i ndryshuar.<br>Për sa më sipër, në lidhje me kërkesën tuaj, ju orientojmë t'i drejtoheni autoritetit vendor për zhvillimin e territorit.. pasi leja që ju kërkoni të pajiseni bën pjesë në lejet e parashikuara në pikën 1 të vendimit të sipërcituar. | E plotë | nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 18.09.2024 | Kërkesë për pezullim procedurash.. | 11.10.2025 | Në përgjigje të kërkesës Tuaj, ju bëjmë me dije sa më poshtë vijon:<br>Agjencia e Zhvillimit të Territorit në mbështetje të VKM-së Nr.725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", është institucioni që ushtron funksionet e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit dhe si e tillë, ka si kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit tekniko-ligjor që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU-së, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit dhe/apo ndërtimit, monitorimin dhe lëshimin e çertifikatës së përdorimit për lejet e ndërtimit të cilat miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, si dhe kontrollin e konformitetit për zhvillimet e propozuara me rastet përjashtimore<br>Për sa më sipër, pas verifikimeve të nevojshme të kryer nga ana jonë nuk rezulton që për parcelat të cilave i referoheni në kërkesën tuaj të ketë leje zhvillimi apo ndërtimi në proces shqyrtimi pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit. | E plotë | nuk ka |
| 2 | 23.09.2024 | Kërkesë për pezullim procedurash.. | 01.10.2024 | Sikuse jeni në dijeni, pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, aplikimi ...<br>Me shkresën..drejtuar institucionit tuaj ju kemi kërkuar informacion në lidhje me statusin juridik të pasurive që preken nga gjurma e projekt propozimit në fjalë, si dhe nëse mbi këto pasuri gjenden objektë informale. Në përgjigje të shkresës sonë na keni infomuar se...<br>Në vijim, pranë AZHT-së është protokolluar ankesa.., i cili pretendon se është ndryshuar pronësia...<br>Për sa më sipër, lutemi të shqyrtoni pretendimet në ankesën në fjalë, duke na informuar mbi pronarin aktual të pasurive objekt i kësaj shkrese. | E plotë | nuk ka |
| 5 | 30.09.2024 | Kërkesë për informacion për pajisje me leje.. | 08.10.2024 | Në përgjigje të shkresës suaj.. ju bëjmë me dije se:<br>Nga verifikimi i kryer, nuk rezultoi të ketë aplikim për miratimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit apo konformitet. ... i cili të përfshijë si pjesë e zhvillimit pasurisë objekt i shkresës suaj. | E plotë | nuk ka |